



Pranuar / Dostiguar Punë/Prodato Received/Delivered	08 - 06 2022	2 viti god year
Organi /Njësia Org /Unit	Nr. Prot Pr Prot Prot No	Shtypja Printed Appendix
SKIMSFLK	3339/2022	1/6



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.363/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.363/2022 të datës 13.04.2022, të parashtruar nga ankuesi me adresë

kundër Vendimit me numër Nr.prot.02-030101-3851/22 të datës 28.03.2022 të Komisionit të Pranimi në Komunën e Shtërpcës, në çështjen juridike “kontestim konkursi” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 07.06.2022, mori këtë:

### V E N D I M

- I. **Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.363/2022 e datës 13.04.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. **Shfuqizohet** Njoftimi i datës 28.03.2022 për rezultatin e përzgjedhjes përfundimtare të kandidatit për procedurën e rekrutimit “Përfaqësues ligjor komunal”, i shpallur nga Komuna e Shtërpcës.
- III. **Anulohet** procedura e rekrutimit për pozitën “Përfaqësues ligjor komunal”, e shpallur nga Komuna e Shtërpcës me datën 18.01.2022 dhe të gjitha vendimet që rrjedhin nga kjo procedurë.
- IV. **Shfuqizohet** Akt emërimi me numër Nr.Prot.02-030101-4155/22 i datës 01.04.2022 i kandidatit të përzgjedhur

V. **OBLIGOHET** Kryetari i Komunës së Shtërpcës që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

VI. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

### A r s y e t i m

Komuna e Shtërpcës fillimisht me datën 19.11.2021 ka shpallur konkursin me numër PRC0001699 për lëvizje paralele për pozitën "Përfaqësues ligjor komunal" në Zyrën e Kryetarit të Komunës, mirëpo që me datën 17.01.2022 Menaxherja e Personelit në Komunën e Shtërpcës ka nxjerrë Vendimin Nr.Prot.02-030/01-648/22 sipas të cilit e ka anuluar këtë konkurs pasi që nuk ka pasur asnjë aplikues. Ndërsa me datën 18.01.2022, Komuna e Shtërpcës ka shpallur konkursin e jashtëm për pozitën "Përfaqësues ligjor komunal" në Zyrën e Kryetarit të Komunës duke u bazuar në dispozitat e nenit 34 paragrafit 1,2,3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe nenit 9 të Rregullores QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Data e njoftimit të konkursit ka qenë 08.02.2022, ndërsa konkursi në fjalë ka qenë i hapur nga data 15.02.2022 deri me datë 25.02.2022, ku në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi. Pas verifikimit paraprak me datën 22.02.2022 Komuna e Shtërpcës, ka njoftuar se kandidatët që i plotësojnë kushtet për të vazhduar tutje për këtë pozitë janë si në vijim; A. H, G. K, J. A dhe S.T .Kurse bazuar në njoftimin e datës 28.03.2022 , nga Udhëheqësja e Personelit për përzgjedhjen përfundimtare kandidatit sipas vlerësimit të komisionit vlerësues të datës 18.03.2022, rezulton se kandidati S. T është shpallur si kandidati më i suksesshëm me gjithsejtë 88 pikë.

Ankuesi i pa kënaqur me këtë procedurë të rekrutimit, me datën 21.03.2022 parashtron ankesë në Komisionin për Pranim të Komunës së Shtërpcës, ndërsa ky i fundit përmes Vendimit me numër të protokollit 02-030/01-3851/22 të datës 28.03.2022, refuzon si të pa bazuar ankesën e ankuesit.

Ankuesi i pa kënaqur me Vendimin e datës 28.03.2022 të Komisionit të Pranimit të Komunës së Shtërpcës, me datën 13.04.2022, përmes e-mailit zyrtar [ankesa.kpmschck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmschck@rks-gov.net), brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke pretenduar se kandidatit të përzgjedhur pa i përfunduar afati për ankimim në Këshill, i është lëshuar akt emërimi nga ana e Komunës së Shtërpcës, i njëjti ka pretenduar se kjo procedurë e konkurrimit është zhvilluar mbi bazën e shumë shkeljeve ligjore dhe parregullsive të shumta që nga formimi i komisionit, përgatitja profesionale e kandidatit të përzgjedhur, vlerësimet lidhur me testin me shkrim dhe me gojë etj, i njëjti kërkon nga Këshilli ta anuloj këtë procedurë mbi bazën e këtyre pretendimeve ankimore.

Me datën 25.05.2022, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës ka nxjerrë Vendimin VK.nr.18/2022, sipas të cilit i ka vazhduar afatin për vendimmarrje edhe për dhjetë (10) ditë tjera ankesës së ankuesit të datës 13.04.2022, me arsyetimin se kjo lëndë ka qenë e pa kompletuar në lidhje me provat e lëndës nga ana e organit të punësimit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.Prot:2055/2022 të datës 13.04.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e ID-së së ankuesit; Njoftimin për mbajtjen e testit me shkrim të datës 09.03.2022, nga Udhëheqësja e Personelit në Komunën e Shtërpcës për kandidatet aplikues; Njoftimin e datës 22.02.2022 nga Udhëheqësja e Personelit për listën e ngushtë të kandidatëve aplikues; Kërkesën e ankuesit të datës 17.03.2022 për rishikimin e testit drejtuar Komisionit të Pranimit dhe Zyrës së Personelit; Renditjen përfundimtare të kandidatëve të datës 18.03.2022 nga Komisioni i Vlerësimit; Shkresën zyrtare të datës 18.01.2022 nga Simbnj; Konkursin e datës 18.01.2022 me numër të referencës RN00008084; Njoftimin e datës 15.02.2022 nga Simbnj për ankuesin; Njoftimin e datës 07.03.2022 për kandidatët nga Udhëheqësja e personelit lidhur me anulimin e testit me shkrim; Kërkesën e ankuesit të datës 16.03.2022 për qasje në testin me shkrim; Njoftimin e datës 28.02.2022; Konkursin e datës 19.01.2022 lidhur me pozitën e punës Arkitekt; Konkursin e datës 19.01.2022 për pozitën e punës Specialistë të inxhinierisë së ndërtimit; Vendimin e datës 28.03.2022 nga Komisioni i Pranimit lidhur me ankesën e ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 15.04.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 29.04.2022 nga Komuna e Shtërpcës; Konkursin e datës 18.01.2022 lidhur me pozitën Përfaqësues ligjor komunal; Vendimin e datës 22.02.2022 lidhur me formimin e Komisionit për Pranim në shërbimin civil; Vendimin e datës 11.03.2022 lidhur me zëvendësimin e anëtarit të komisionit; Njoftimin e datës 18.03.2022 lidhur me kandidatin fitues; Pyetjet e testimit me gojë nga ana e Komisionit vlerësues; Renditjen përfundimtare të kandidatëve të datës 18.03.2022; Njoftimin e datës 28.03.2022 lidhur me kandidatin e suksesshëm të kësaj procedure; Konfirmimin e datës 30.03.2022 nga Simbnj për përfundimin e konkurrimit; Vendimin e datës 17.01.2022 për anulimin e konkursit të datës 19.11.2021 për pozitën Përfaqësues ligjor komunal; Vendimin e datës 04.05.2022 lidhur me transferimin e nëpunësit S. T ; Akt emërimit të datës 01.04.2022 për nëpunësin S. T; ID-në e kandidatit S. T së bashku me përvojën profesionale dhe të punës të bashkangjitura në shkresat e lëndës; Dëshmitë për dosjen e kandidates A. H lidhur me përvojën profesionale dhe atë të punës; Dëshmitë për dosjen e kandidates G. K-S lidhur me përvojën profesionale dhe atë të punës; Dëshmitë për dosjen e kandidatit J. A lidhur me përvojën profesionale dhe atë të punës; Vendimin VK.nr.18/2022 të datës 25.05.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesa për përgjigje në informata shtesë të datës 07.06.2022 nga KPMSHCK për udhëheqësen e personelit të komunës së Shtërpcës; Përgjigjen e datës 07.06.2022 nga udhëheqësja e personelit të komunës së Shtërpcës për KPMSHCK-në.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, konstaton se ankesa e ankuesit **është e bazuar, sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon që procedura e rekrutimit për pozitën "Përfaqësues ligjor komunal" në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës së Shtërpcës është zhvilluar me shkelje procedurale dhe duke u bazuar në të gjitha provat e lëndës, ka konstatuar që kandidati i përzgjedhur për pozitën "Përfaqësues ligjor komunal" në bazë të dëshmisë së dosjes posedon Diplomën me Nr.480 të datës 02.10.2009 të lëshuar nga Republika e Serbisë ,

me te cilën dëshmon se me datën 24.04.2009 ka përfunduar studimet e shkallës së parë të lartë në Fakultetin Juridik ne Mitrovicë e Veriut –Drejtimi i Përgjithshëm, sipas te cilës ka marrë titullin “Jurist”, po ashtu në bazë të dosjes së kandidatit i njëjti posedon diplomën me numër 02-135/2020 të datës 25.12.2020, e lëshuar nga Republika e Serbisë, Universiteti Union-Nikolla Teslla ne Beograd me te cilën dëshmohet se ka përfunduar studimet e nivelit master në drejtimin “Programi studimor e drejta ndërkombëtare e punës”, mirëpo që në dosje nuk posedon vendim nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës për nostrifikimin e këtyre diplomave, mbi bazë të kësaj me datën 07.06.2022 nëpërmjet e-mailit zyrtar kemi kërkuar informata zyrtare nga Menaxherja e Personelit të Komunës së Shtërpcës znj.I. M se: *“...se kandidati i përzgjedhur me rastin e aplikimit për këtë pozitë a ka dorëzuar vendim për nostrifikim të diplomës dhe nëse ka dorëzuar ju lutem na e dërgoni një kopje të tij”* ndërsa znj. I. M nëpërmjet e-mailit zyrtar ka njoftuar Këshillin që: *“Kandidati S. T gjate konkurrimit ka paraqitur diplomën e Universitetit Union “Nikolla Teslla”ne Beograd me datën e përfundimit te studimit 12.03.2019, e cila është verifikuar nga noteri pa nostrifikim. Siç dihet komisioni për nostrifikimin e diplomave nuk punon qe disa vite, kështu qe palët e interesuara nuk kane mundësi qe te nostrifikojnë diplomat e veta, prandaj konsideroj se kandidati nuk ka pasur mundësi qe te nostrifikoj diplomën gjë që është edhe e vërtetuar nga ana e tij, prandaj ne si institucion me refuzimin e kandidateve te cilët për arsyet e pajustificueshme nuk kane pasur mundësi qe te përfundojnë procesin ne atë mënyrë kanë bërë diskriminim”,* si rrjedhojë meqenëse në dosje të kandidatit të përzgjedhur S. T nuk ka dëshmi për nostrifikim të diplomës i njëjti nuk do të duhej të përfshihej në listën e shkurtër apo të përzgjidhej nga Komisioni i Pranimit, sepse të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të cilët diplomat i kanë fituar jashtë territorit të Republikës së Kosovës duhet t’i nënshtrohen procedurës së njohjes/barasvlerës në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë siç përcaktohet me dispozitat e nenit 3 paragrafit 1 të Udhëzimit Administrativ (MASHT)-Nr.12/2018 Parimet dhe Procedurat e Njohjes së Diplomave, Gradave dhe Kualifikimeve të Shkollave të Larta Profesionale dhe Universitare të Fituara Jashtë Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *“Të gjitha diplomat e shkollave të larta profesionale si dhe ato universitare të fituara jashtë vendit me qëllim punësimi, do t’u nënshtrohen procedurave të njohjes/barasvlerës në MASHT”,* në këtë kuptim kandidati i përzgjedhur S. T është dashur që aplikacionin e tij ta dorëzojë me të dhëna të sakta duke i bashkangjitur edhe dokumentacionin e nevojshëm, sepse dokumentacioni i pa kompletuar refuzohet siç përcaktohet me dispozitat e nenit 15 paragrafit 1, 2 dhe 3 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën ne Shërbimin Civil te Republikës se Kosovës i cili përcakton se: *1.Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërliohen me verifikimin paraprak. 3.Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin në fazën e mëtejshme, e cila njihet si lista e ngushtë”* dhe meqenëse aplikacioni ka qenë i pakompletuar i njëjti është dashur të refuzohet nga Njësia Përgjegjëse konkretisht Udhëheqësja e Personelit të Komunës së Shtërpcës, kështu që në këtë rast është vepruar në kundërshtim me dispozitat e lartcekura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton që procedura e rekrutimit për pozitën "Përfaqësues ligjor komunal" në Zyrën e Kryetarit të Komunës i shpallur nga Komuna e Shtërpcës është zhvilluar në kundërshtim me nenin 15 paragrafin 1, 2 dhe 3 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenin 34 paragrafin 6 nën paragrafin 6.1 dhe paragrafin 7 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT)- Nr.12/2018 Parimet dhe Procedurat e Njohjes së Diplomave, Gradave dhe Kualifikimeve të Shkollave të Larta Profesionale dhe Universitare të Fituara Jashtë Republikës së Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nuk i ka shqyrtuar pretendimet e tjera ankimore të ankuesit të parashtruara në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, sepse ka konstatuar se ka pasur shkelje të dispozitave procedurale dhe materiale gjatë zhvillimit të kësaj procedure për pozitën "Përfaqësues ligjor komunal" në Zyrën e Kryetarit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se organi i punësimit Komuna e Shtërpcës, pas pranimit të Vendimit të Këshillit është e obliguar që të ndërmer veprimet administrative me qëllim të zbatimit të obligimeve ligjore që rrjedhin sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmer veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e Vendimit të Këshillit.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.363/2022, datë 07.06.2022.

Ardita Perçuku-SHYTI

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



Vendimi i dorëzohet:

- ❖ Ankuesit Jonuz Ahmeti;
- ❖ Kryetarit të Komunës së Shtërpcës;
- ❖ Udhëheqëses së Personelit në Komunën e Shtërpcës dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK- së.

